

DPK/DMP  
02

03-1415/13  
15-05-2013

Nr. Regj. 18235/12

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Shkelzen(Mehmet)Maliqi, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 02.05.2013 morri këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Shkelzen(Mehmet)Maliqi, i lindur më 26.10.1947 në Rahovec, tani me vendbanim në rrugën "Nazim Gafuri", nr. 27, në Prishtinë, ka kryer fakultetin Filozofikë, i martuar baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

### **Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse si zyrtarë i lartë publik në pozitën e Këshilltarit politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetorë të pasurisë, brenda afatit të paraparë ligjor gjer më 31 mars 2012, në Agjencinë Kundër Korrupsion, -  
- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, andaj i shqiptohet,

## **D Ë N I M I**

**Më gjobë në shumë prej 300(treqind)**, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjë agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **15 ditësh**, duke iu llogaritur nga **20 €**, për një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është e obliguar të paguaj shumën prej **5.€**, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

## **A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë**, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-1816/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke propozuar të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria më datë 27.07.2012 mori vendim në ç rast e shpalli përgjegjës dhe i shqiptoi dënimin, mirëpo kundër aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë i pandehuri Shkelzen Maliqi, e të cilën ankesë Gjykata e lartë për Kundërvajtje e ka aprovuar në ç rast me Aktvendim GJL. nr. 1225/2012 të datës 31.10.2012 e ka abroguar vendimin e shkallës së parë duke e kthyer lëndën në rivendosje. Gjyqtaria veproi sipas vërejtjeve të gjykatës, morri në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e ka bërë deklarin e rregullt vjetorë **por me vonesë** duke pranuar kundërvajtjen, andaj lut gjykatën të ketë parasysh se është hera e parë që bije ndesh me ligjin dhe ti shqipton një dënim më të butë. Poashtu u dëgjua dhe Përfaqësuesi i Agjencisë Kundër Korrupsion Agron Behrami, i cili prezantoi dokumentin zyrtarë-formularin e deklarimit për të pandehurin Shkelzen ku shihet se i njëjti e ka deklaruar pasurin më datë 23 prill 2012, andaj nuk e ka respektuar afatin e fundit ligjorë si që e parasheh ligji dhe atë 31.03. 2012. U dëgjua dhe Lumnije Lipovci, në cilësinë e dëshmitares, e cila deklaroi se i ka dërguar i-mail dhe e ka lajmëruar me telefon Shkelzen Maliqin për obligimin e deklarimit të pasurisë. Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimit të deklaratës së të pandehurit, deklaratës së Lumnije Lipovci si dhe deklaratës së përfaqësuesit të Agjencisë Kundër Korrupsion Agron Behrami, vlerësimi i shkresave të tjera të lëndës e posaçërisht nga administrimi i provës materiale të prezantuar gjyqtaria në mënyrë bindëse vërtetoi se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, për çka e shpalli përgjegjës dhe e dënoj me gjobë duke aplikuar nenin 9 në ç rast i shqiptoi dënimin nën minimumin e paraparë me ligj, ashtu si është cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, nën të cilat është kryer kundërvajtja, peshën e veprës së kryer, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Me sa u tha u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**  
Nr. Regj. 18235/12, datë 02.05.2013

Gjyqtaria  
Azra Cakolli

  
**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Gjykatës së Apelit-Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej **8 ditësh**, nga data e pranimi të njëjtit e nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.